



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tridhjetë e shtatë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.04.2025**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|----------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 15. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 16. <u>Negidet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 17. <u>Nexhmedin Balaj AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 18. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 5. <u>Veton Kurti, LDK;</u> | 19. <u>Florin Dreshaj, VV;</u> |
| 6. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajçi, LDK;</u> | 22. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 10. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 24. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 11. <u>Arianit Selmanaj LDK;</u> | 25. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | 26. <u>Djula Karisik, GIBI;</u> |
| 13. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u> | |
| 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-të e xhimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në <https://www.youtube.com/watch?v=P3uHqKA2F5I> "shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë e shtatë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025,
4. Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Transparencë Komunale,
6. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Subvencione,
7. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Tregun tërë ditë në Istog,
8. Shpallja në diskutim publik e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale,
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për destinimin e lokacionit për varreza në fshatin Rakosh,
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- njoftoi se pas mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) më 22.04.2025, janë marrë vlerësimet për katër prona nga Agjencia për Vlerësimin e Pronave. KPF-ja rekomandoi që këto pika të shtohen në rendin e ditës për mbledhjen e Kuvendit të datës 19.05.2025. Gjithashtu, ai sqaroi një gabim në njoftimin për komisionin e ankesave ndaj ndarjes së bursave, ku kishte përmendur tre anëtarë të Kuvendit, ndërsa ishin dy. Ai kërkoi falje për këtë lëshim dhe pyeti Kuvendin dhe ekzekutivin nëse kishin ndonjë sugjerim apo vërejtje lidhur me rendin e ditës. Fjalën e mori Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- mbledhjen e kaluar ekzekutivi e ka bërë një zotim që do të vjen me një draft Rregullore për emërimin e objekteve komunale, desha ta di se çfarë po ndodhë?

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- një prej pikave përpos pikave shtesë që i kemi në planifikim me i listuar në këtë rend dite ka qenë edhe njoftimi për themelimin e grupit punues për hartimin e projekt Rregullores për emërtimin e institucioneve kulturore, sportive, arsimore, shëndetësore dhe institucioneve tjera që ka të bëjë me emërtim të cilin e diskutove edhe ti. Personalisht jam kryesuesi i atij grupi punues, janë pothuajse të gjithë drejtorët e ekzekutivit, ka përfaqësues prej sportit, të organizatës së familjes së dëshmorëve, të burgosurve politikë, prej OVL UÇK, prej Zyrës së Informimit, pothuajse të gjithë sektorët e jetës që e përbëjnë komunën e Istogut dhe që ky grup punues ka me e hartuar Rregulloren për emërtimin e institucioneve, parqeve, shesheve, shkollave çka do që ne e kemi në planifikim dhe ato që na vijnë përmes kërkesave që janë dorëzuar e para mos gaboj ka qenë prej anëtares së Kuvendit znj. Floriana Maxharraj edhe tutje tjerat, edhe debatet që i kemi pasur lidhur me emërtimet e institucioneve. Besoj shumë që bashkë me grupin në mbledhjen e ardhshme kemi me ardhur me një draft të Rregullores të cilën kemi me e shpallë në diskutim publik e pastaj me i vazhduar procedurat e tjera. Faleminderit që e ngrite si çështje! Tani po vazhdoj me dy pika jashtë rendit të ditës që i propozoj të hyn në rend dite për sot, e para është Shfuqizimi i Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive dhe pjesa e dytë, diskutimi që e kemi pasur edhe me ju edhe me sindikatën dhe me një pjesë dërmuese të zyrtarëve është me e vazhduar propozimin për kompensimin për shujtat për zyrtarët publikë. Llogaritë që janë bërë, del që nëse vazhdojmë me të njëjtën shifër që ka qenë e aprovuar herën e kaluar po prej këtij Kuvendi me 3.50 euro (tri euro e pesëdhjetë cent) në shumë ditore e që i bie prej 647-728 ditë pune për vitet 2022-2024, 196 punëtorë në total 2264.50 euro për punëtor janë 443.000 e 800 sosh në të cilat ne hymë në obligim po e ceku në momentin e parë që krijohen kushtet financiare për kompensim. Pse po e them këtë, në muajin janar jemi dëmtuar prej përmbaruesit për kompensim të shujtave për kontratën kolektive diku rreth 700.000 euro, vitin e kaluar e ka prek shifrën 3.000.000 euro gjatë tërë vitit. Mirëpo edhe me mirëkuptimin e zyrtarëve edhe sindikatës dhe të anëtarëve të Kuvendit që kanë pasur diskutime me plotë të drejtë, kisha kërkuar që kjo pikë të bëhet pjesë e rendit të ditës dhe të kalojë shuma prej 3.50 euro (tri euro e pesëdhjetë cent) me e cek që në momentin e parë të krijimit të kushteve financiare ne me e vazhduar me ju përgjigj si obligim zyrtarëve publik për shujtat ditore të ushqimit.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Kryetari! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë e pata një vërejtje te krejt diçka tjetër por po lidhem te kjo çka e tha kryetari, po më vjen mirë që e keni sjellë për shfuqizim Rregulloren për Kategorizimin e Klubeve Sportive sepse ka qenë tmerr. Dhe vërejtjet e mia këtu kanë qenë se drejtoresha në dëgjim publik i ka përmendur ekspertët, kush janë ata që kanë punuar në atë Rregullore që bie ndesh me ligjet në fuqi për sportin. Dhe Lëvizja Vetëvendosje e përkrah për me e fut në rend dite. Edhe një vërejtje e pata kryesues, shumica e materialit na ka ardhur djc në ora 18:00 dhe kjo po përsëritet disa herë pastaj nuk po kemi mundësi as me e lexuar me e ditë si po votojmë pastaj po na fut në lajthitje këtu kur po votojmë shkël e shko. Vota është koxha obligim, se përfaqësojmë votën e qytetarit, dhe po të lus që më mos të ndodhë. Pastaj mbledhja e sotme që e keni mbajtur e Komitetit për Politikë dhe Financa, ato pika janë shumë të rëndësishme se qytetarëve ju ka marrë prona më shumë se dy vite dhe i keni maltretuar qytetarët duke ardhur në komunë e duke shikuar se a është përfunduar e sot e mbani mbledhjen, mua po më duket që ka qenë vetëm për mëditje. Keni mundur me i propozuar këtu ashtu siç ka ndodhur shpesh e kishim votuar se nuk jemi për me u dëmtuar qytetarët, por jemi për mënyrën se si po i procesoni gjërat dhe si po punoni. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- në propozimin tim asnjëherë nuk e ceka që Rregullorja është e jashtëligjshme, drejtoresha me plotë të drejtë ka thënë që ka qenë pjesë e grupit të hartimit ekspertë, përfaqësues të klubeve sportive që janë pjesë edhe e aplikacioneve në secilën thirrje që ka të bëjë me subvencionim të sporteve. E kemi diskutuar edhe në Kuvend, një pjesë e propozimeve më kujtohet të Agronit janë bërë pjesë e Rregullores, përndryshme përgjysmë me ekzekutivin përgjegjësinë e kanë edhe klubet sportive se janë me ekspert se unë e se ju. Arsyeja pse e thashë është edhe politike edhe qytetare për shkak se po konsideroj që në mënyrë të pa barabartë në raport me arritjet që ata i kanë, edhe një lloj diskriminimi i lehtë të vlerësimi i të arriturave qofshin ato kolektive personale varësisht prej orientimit të klubit. Sa i përket çështjes së mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, vlerësimet prej Ministrisë së Financave kanë ardhur pas mbajtjes së KPF-së që mbahet në orarin e rregullt, ligji e thotë që te çështja e këmbimit të pronës nuk mund të vijë në rend dite pa kaluar në KPF, pse me e lëshuar në një mbledhje të Kuvendit për shkak të një mbledhje të KPF-së dhe me proceduar me këmbim që njerëzit me i marrë kompensimet e veta vetëm për një vonesë që e ka pasur organi që merret me vlerësimin e pronave. Nuk ka qenë neglizhencë as për një mëditje, por ka qenë vonesa që ata e kanë bërë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Kryetari! Fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- pikërisht ato pikat që i ka propozuar Agroni janë ato që bien ndesh me Rregulloren për Sportin me ligjet në fuqi, ato që është dashur me i përmirësuar edhe ka ra ndesh edhe me ligjin. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- grupi jonë e përkrah shfuqizimin e kësaj Rregullore siç e potencoi edhe kryetari ka qenë diskriminuere dhe besoj që ka me ardhur një Rregullore e re që ja u jep meritat të gjithë sportistëve. Si dhe për pikën dy, ne e kemi një vërejtje sa i përket thirrjes së mbledhjes së KPF-së ku një orë përpara u mbajt, pa marrë parasysh se cilat janë pikat ne duhet me i pas materialet dhe me ditë se çfarë po votojmë. Çdo seancë thirret 7 ditë pas mbledhjes së Komitetit e jo një orë pas me na ardhur ato. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- desha vetëm një sqarim se u tha që mbledhja e KPF-së është mbajtur vetëm për mëditje dhe dua të informoj se mëditje nuk merret, merret vetëm një mëditje brenda muajit. Mos të dezinformohet opinioni, prandaj nuk ka mëditje. E kemi kryer një procedurë e pamë edhe në material që me datë 25 është bërë vlerësimi i ministrisë, është mirë që këto prona të japen sepse është këmbim.

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka rreth rendit të ditës? Pasi që nuk ka, fillojmë pra me këto katër propozimet që i bëra unë : Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Ardi Maraj. Kush është që kjo pikë të hyn në rend dite për sot?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me propozimin e dytë, Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Avdullah Bytyçi. E ftoj drejtorin këtu që ta na jep një sqarim.

Agon Dreshaj- jep sqarim lidhur me këtë pikë të propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- po i bie që ne jemi kundër këtyre pronave, nëse votojmë për nuk po e di për çka po votojmë se nuk kemi asnjë material, me votuar kundër munden qytetarët me thënë këta janë kundër këmbimit të pronave, kishte me

qenë mirë me e shtyer për seancën tjetër nuk kemi asnjë lloj materiali.
Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë kisha kërkuar që drejtori me na zgjeruar pak më mirë cili është interesi apo qëllimi i komunës që po bëhet ky këmbim dhe saktësisht ku janë pronat, materiali është duke u shpërndarë tani, unë e kam këtë informacion por shumica nuk e kanë, vetëm me na sqaruar pak më mirë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- unë vetëm e lashë që kur të vjen radha e këtyre pikave pasi të futen në rend dite me jep sqarim dhe me i prezentuar, por pasi po më kërkohet tani, po vazhdoj. Drejtori prezanton dhe jep sqarimet për pikat e propozuar.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro 0 kundër dhe 4 abstënim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e tretë të propozuar Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personit fizik z. Brahim Sejdaç,

Agon Dreshaj- prezanton dhe jep sqarimet e nevojshme për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 22 vota pro 0 kundër dhe 2 abstënim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë me pikën e katërt të propozuar Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Istogut me pronën e paluajtshme të personave fizikë z. Avdullah Bytyçi, Ibrahim Bytyçi, Shkumbin Bytyçi, Haxhi Bytyçi

Drejtori Agon Dreshaj- prezanton dhe jep sqarimet e nevojshme për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin, fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha vetëm një pyetje a është pjesa ku po ndërtohet një restorant te ajo pjesa lartë?

Kryetari i Komunës- pjesa ku po mendon ti Negjdet është pjesë e Agjencionit të Pyjeve ku po ndërtohet restoranti.

Drejtori Genc Ademaj- jep sqarime shtesë lidhur me këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj- ne si Lëvizje Vetëvendosje e përkrahim këtë këmbim, nuk e di sa ju kujtohet ka qenë edhe kërkesë e jona më herët që të punohet diçka në këtë drejtim në rregullimin e Bollovanit për interes të përgjithshëm komunal. Shpresoj shumë që të punohet në atë drejtim dhe mos të mbetet vetëm ndërrimi i pronës, por të punohet që mos të ketë vërshime.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 22 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota pro 0 kundër dhe 3 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me radhë e kemi propozimin e ekzekutivit për Shfuqizimin e Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive. Po votojmë, kush është që kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Vazhdojmë me pikën tjetër të propozuar nga ekzekutivi, Kompensimi i shujtave për zyrtarët publikë, kush është kjo pikë të procedohet në mbledhjen e sotme?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kjo pikë hyn në rend dite për mbledhjen e sotme.

Hedh në votim rendin e ditës për sot me propozimet e dhëna në tërësi, kush është të miratohet?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungon Njomza Demaj që për shkaqe shëndetësore ende nuk mund të marrë pjesë.

Të pranishëm në mbledhje janë 20 anëtarë të Kuvendit (disa prej tyre kanë lëshuar mbledhjen, disa të tjerë kanë dalë dhe kanë hyrë prapë).

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që nuk ka diçka tjetër e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton Raportin financiar për tre mujorin e parë (Janar -Mars) të vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- Raporti për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2025 tregon një mospërputhje të dukshme mes planifikimeve dhe të ardhurave të mbledhura. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, të hyrat kanë rënë në 77,224€, ose 24.64%, ndërsa planifikimi për 2025 është përmbushur vetëm në masën 16.4%. Në vitin 2024, Komuna e Istogut planifikoi të mbledhë 22,305€ nga bujqësia, por mbledhi vetëm 8,174.5€, ose 36.64% e objektivit. Pavarësisht kësaj performance të dobët, planifikimi për 2025 u rrit me 39.71%, duke arritur në 37,000€. Megjithatë, në TM1 2025, të hyrat nga bujqësia ishin vetëm 2€, që përfaqëson 0.0054% të planifikimit. Planifikimi dhe të hyrat në bujqësi janë si vijon: Licencat për afarizëm: Planifikimi 5,000€, të ardhura 0.00€. Ndërrimi dhe destinimi i tokës bujqësore: Planifikimi 20,000€, të ardhura 0.00€. Qiraja për toka bujqësore komunale: Planifikimi 12,000€, të ardhura 0.00€. I vetmi burim i të hyrave në TM1 2025 ishin taksat administrative, ishte shuma prej 2.00€. Për vitin 2025, komuna planifikoi të mbledhë 333,000€ nga planifikimi hapësinor dhe rregullativ, por mbledhi vetëm 34,002.5€, ose 10.21% e objektivit. Krahasuar me TM1 2024, ky sektor shënon një rënie të ndjeshme, sidomos në dy kategori kryesore, taksa komunale për leje ndërtimi dhe taksa për legalizimin e objekteve, pyetja ime është, cilat janë shkaqet e të ardhurave kaq të ulëta nga taksa për leje ndërtimi? A ka pasur vonesa administrative, rënie të kërkesës për ndërtime në Istog, apo çfarë, si dhe pse u rrit planifikimi me 50% për taksat e legalizimit të objekteve, kur në 2024 u përmbush vetëm 79.3% e objektivit? Te buxheti qiratë e objekteve publike në vitin 2024, komuna planifikoi të mbledhë 4,000€ nga qiratë

c objekteve publike, por nuk mblodhi asnjë të ardhur. Pavarësisht kësaj, planifikimi për 2025 u rrit me 25% (në 4,500C). Fatkeqësisht, në TM1 2025, të ardhurat mbeten zero, ashtu si në çdo tremujor të 2024. Tatimi në tokë dhe mbledhja e borxheve, planifikimi i të hyrave për këtë vit është thuajse i njëjtë me atë të vitit të kaluar, siç është edhe realizimi i të hyrave. Në vitin 2024 ishin planifikuar të hyra në vlerë 116,411€ ndërsa realizimi ishte 0.00 C, ndërsa planifikimi është bërë njëjtë edhe për këtë vit. Kam një pyetje: Çfarë hapash politik ka ndërmarrë qeverisja lokale që të ndryshohet gjendja në tërren dhe ky planifikim të jetë i arsyeshëm e rrjedhimisht të kemi mbledhje të borxheve. Raporti i të hyrave vetanake për këtë TM1 i komunës së Istogut zbulon një mospërputhje të madhe mes planifikimit dh të ardhurave të mbledhura në një rënie prej 24.64% krahasuar me TM1 2024 dhe në përmbushje vetëm 16.4% prej tyre.

Drejtori Genc Ademaj- e kam një përgjigje të shkurtër. Nëse i keni shikuar mirë, që po del që nuk e keni shikuar mirë Raportin e tre mujorit të fundit të vitit të kaluar TM4 komuna e Istogut ka tejkalim, nëse kishte qenë ajo performance kaq e dobët siç e prezantove ti, po të them që kemi tejkalim të planit të të hyrave vetanake për vitin 2024. Si mundemi ne me e pasur një planifikim të dobët ku kemi tejkalim prej 734.000€. Tani kemi me i bartë bashkë me juve nëpër projekte të reja në pikën tjetër të rendit të ditës. Zërat që ti ju referove, edhe në bujqësi c din që këtu e kemi shfuqizuar në Rregullore për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba vitin e kaluar taksën prej 5.00€ që është i vetmi burim te drejtoria e Bujqësisë. Te pjesa e Urbanizmit te Rregullorja për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba e kemi vendosur çështjen e ndryshimit të destinimit të tokave për shkak që me pasur një kordinim më të mirë mes planifikimit urban dhe mjedisit me lejet ndërtimore dhe kërkesat e qytetarëve. Vazhdon sqarimin dhe përgjigjen.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- unë u mundova me i dhënë sugjerimet dhe kritikën e mia. Për kategoritë e njejtë edhe në vitin 2024 i kam jap sugjerimet dhe kritikën e njejtë dhe përgjigjia jote ka qenë se ne e ndjekim trendin e njejtë ndër vite dhe duke u nisur nga ajo nuk e di a është dashur me pas ngritje a jo. Të paktën planifikimi është dashur të jetë më real. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj- përgjigjet dhe jep sqarime shtesë.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit drejtor, po më doket që ekzaminimi ishte komplet. Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha vetëm një sqarim për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë sepse ka pasur ankesa prej qytetarëve se janë shpërndarë me voncesë, dihet që data 30 prill është afati i fundit, desha ta di a ngarkohen me kamatë pasi

që dihet që vonesat janë bërë prej ekzekutivit deri sa e keni caktuar bazën tatimore. Pra janë ankuar që faturat kanë ardhur me 28-29 prill.

Drejtori Genc Ademaj- faturat me 28-29 prill nuk kanë ardhur, dhe ekzekutivi nuk e ka pasur dhe nuk e ka asnjë përgjegjësi të pjesa e shpërndarjes, është marrëveshje që e bëjmë me pjesën e postës, se obligohemi t'i mbulojmë shpenzimet e shpërndarjes por ne as nuk i shtypim e as nuk kalkulojmë faturat. Faturat kalkulohej nga programi në formë automatike që është në kuadër të ministrisë së Financave. Ne e bëjmë vetëm pagesën e shërbimit postar. Masa ndëshkuese nuk është ngarkesë e madhe.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- unë e pata një kërkesë për drejtorin, kur përgjigjet ju lutem mo ofendoni. Ja fillove me ju përgjigjur Florianës me ti nuk e ki kuptuar, Floriana nuk është rastësisht asambleiste dhe nuk është rastësisht prej grave më të votuara në Kuvend dhe pikërisht fakultetin e ka kryer për këtë analizë që e bëri. Dhe ju ka referuar numrave drejtor. Nuk është e ndershme me ju referuar me nuk din ti. Faleminderit!

Drejtori Genc Ademaj- unë nuk e di që i thashë nuk e di, por i thashë që ka mundesi që nuk e ki kuptuar e që nuk është ofenduese por nëse nuk e ka kuptuar unë jam këtu për sqarime. Ne shkollën mundemi me e përfunduar të gjithë por kur ballafaqohesh me planifikim, me analizë e ki nganjëherë informata më shumë se një zyrtar që ballafaqohet me ato. Floriana tha që komuna e Istogut ka pas një realizim të dobët të të hyrave vetanake të planifikuara dhe nuk mundem ta mbroj atë kur ke tejkalim 1 milionë euro. Këtë nuk mundem ta pranoj. Edhe ju nganjëherë nuk duhet të jeni të ngutshëm. Ka mospërputhje të inkasimit këtë e pranoj dhe ajo nuk ndodhë për shkak të gabimeve tona. Nëse dikush ndonjëherë e ndjen vetën të ofenduar nga ana ime, unë ju kërkoj falje edhe publikisht.

Kryesuesi i Kuvendit- nuk më tingëlloj si ofendim. Sepse nese kishte ndodhur kisha reaguar unë. A ka edhe dikush diçka pasi që jo dhe ky ishte njoftim, atëherë vazhdojmë me pikën tjetër.

Shqyrtimi i pikën 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës. Bartja e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore të hyrave të bartura nga viti fiskal 2024 dhe të hyrat e tejkaluara në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- isha ndalur te pika te bartja e buxhetit, e para është stacioni i autobusëve që po barten 15.000 euro edhe pse kemi pasur diskutime edhe më herët për këtë, kisha kërkuar nga drejtori me na sqaruar pak se pse shkojnë këto mjete për stacionin e autobusëve. E dimë që para vitit të kaluar i kemi dërguar 50.000 euro dhe MAPL-ja na ka kthyer që ato nuk kanë qenë në rregull, dhe kanë qenë për paga e që gjoja ne e kemi rifunksionalizuar atë, e tani prapë vjen për rifunksionalizim, e dimë raportin e Auditorit, është thënë se ato mjete nuk kanë shkuar për subvencionin e caktuar, d.m.th janë keq menaxhuar. Është një kompani që po e shoh që nuk po ec. Edhe kur i kemi dërguar ato mjete më herët, e kam thënë se ai nuk ka as plan biznesi se çfarë kanë me bërë. Kështu që nuk jam i pajtimit që me u derdhur mjete kështu pa asnjë plan. Dhe pika dytë ishte renovimi i palestrës, në kuadër të kësaj thirrje atëherë ka qenë që ministria ka me e financuar një pjesë të vet prej 300.000 euro ndërsa komuna 200.000 euro vetëm për kulmin. Tani janë dy pika që nuk na tregove, njëra 140.000 euro dhe tjetra është projekt i ri. Pak nëse mundesh me na shpjeguar. Faleminderit!

Drejtori Abedin Kabashi- Unë jam në kontakt me komunat tjera si ne, po e llogariti edhe komunën e Klinës, Deçanit, Skenderajit të gjitha stacionet e autobusëve subvencionohen prej komunës. Shpresoj që sa më shpejt e funksionalizojmë, se pa e subvencionuar do të jetë problem për të mbijetuar.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- edhe unë desha të ndalem te pika e njejtë. E dimë që gjatë këtij mandati janë ndarë 50.000 euro për stacionin e Autobusëve, ku 30.000 euro kanë qenë paga për punëtorët dhe pagesa të tatimeve. Shumicën e përgjigjeve unë i mora. Se edhe unë e pata pyetjen si duam ta rifunksionalizojmë stacionin me 15.000 euro ku e dimë që me 50.000 euro nuk kemi mundur.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- një gjë duhet me e pas parasysh është kosto ma e vogël me e mbajtur një ndërmarrje nën mbijetesë se sa me e lënë me falimentuar me u shuar dhe në momentin që na paraqitet neve si nevojë me e krijuar të re. Kjo është ajo çka po ndodhë deri në funksionalizimin e stacionit. Tregu i ri është ndërtuar afër stacionit, jemi duke tentuar me e gjetur bazën ligjore te inkasimi që bëhet prej shfrytëzimit të tregut prej tregtarëve me hy dhe me u inkasuar në arkën e stacionit të Autobusëve në mënyrë që me garantuar stabilitet financiar përtej kësaj momentin që fillojnë gravitetet e autobusëve brenda stacionit bashkë me taksën që e paguajnë në baza ditore ose me linja si e kanë, mendoj që krijohet një stabilitet. Përndryshe 350.00 euro është rrogë minimale sot, njerëzit që udhëheqin borde janë njerëz që duhet me pas një ekspertizë dhe një përvojë të madhe dhe kur hap konkurs për njerëz me kritere të tilla me një page 350.00 euro mundësa me i rekrutuar është minimale. Edhe përveç diskutimeve interne kërkoj edhe para Kuvendit nga drejtori i drejtorisë së Shërbimeve Publike që me hapa sa

më shpejt të ec drejtë funksionalizimit edhe marrëveshjeve që duhet me i bërë me inspektoriatin qendror bashkë me atë komunal dhe policinë e Kosovës që me i obliguar operatorët ekonomikë me u bë pjesë dhe me na u heq barra financiare neve dhe qytetarët me pasur shërbimin më të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Florin Dreshaj.

Florin Dreshaj- desha të ndërlihem me kryetarin. Kryetar në qoftë se nuk janë aktiv inspektorët edhe policia ka me vazhduar ashtu siç ka qenë tani. Ata duhet me i detyruar kur te paguajnë taksën në Pejë e në Prishtinë me paguar edhe në Istog. Desha të ndërlihem pak me kanalet e ujitjes, drejtori e përmendi që ka me u ba mirëmbajtja e kanaleve por nuk e kuptova tamam, a vetëm kanalet me ujë të Drinit apo kanë me u mirëmbajtur edhe kanalet e tjera të ujitjes. Edhe i përmendi që kanë me u ndërtuar edhe kanalet të tjera të ujitjes edhe këtu kemi një shqetësim se si vend rural po shkatërrohen të mbjellat për shkak të mungesës së ujitjes e disa që janë ndërtuar është ujitja më e dobët se sa kur ka qenë pa kanale për shkak të punëve të këqija që janë bërë. Kisha pasur qejf një sqarim për këto.

Drejtori Genc Ademaj- ne ndajmë buxhet bashkë me Kuvendin për me i betonuar kanalet e ujitjes për me ja lehtësuar procesin e ujitjes bujqëve të komunës së Istogut edhe pse pastaj ato janë asete të ndërmarrjes publike "Drini i Bardhë" se në mungesë të mjeteve të tyre nuk mundën me e realizuar ose ma trego një kanal që ata deri sot e kanë ndërtuar. Aty ka keq menaxhim por realisht të hyrat e tyre të vogla ja u kanë pamundësuar atyre. Mirëmbajtja realisht ka filluar, ata e kanë një projekt që kanalet e mbyllura kanë me i trajtuar dhe me i hap ato të betonuara realisht. A ka pasur keq realizim nga ana e operatorëve, po e them edhe unë që ka pasur. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- një lloj praktike e zakonshme që ne vend që të trajtohet si problem e të shfrytëzohen me kohë këto vetëm barten. Kjo formë e menaxhimit me buxhetin më shumë tregon që buxhetimi nuk po bëhet mirë. Pra ka mungesa të subvencioneve në sport, në bujqësi, mungesë investimesh kapitale e gjitha kjo duke humbur kohë që pastaj këto të barten deri në vitin e fundit zgjedhor që muajt e fundit me u dukur që po punohet. Me e pas të vetmin kriter me e dhënë ndonjë subvencion, me kriterë të shfrytëzimit të mëvonshëm politik. Ne kemi kështu si vërejtje që këto të shfrytëzohen me kohë dhe mos të barten vitin e fundit zgjedhor.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- të hyrat që po i kërkojmë për bartje d.m.th tejkalim i kemi 734.000 euro që janë jashtë planifikimit që nuk kemi mundur ta zëmë afatin për bartje brenda vitit fiskal 2024 për shkak të afateve ligjore që nuk na lejojnë.

Për bartje i kemi kërkuar 215.000 euro që nuk janë shpenzuar vitin e kaluar. Vazhdon përgjigjen dhe sqarimet.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- sot jemi duke e bërë bartjen e mjeteve mirëpo a rrezikohet ndonjë projekt që janë marrë mjetet nga përmbaruesve. Konkretisht desha të pyes për një projekt në Banjë parkun e Banjës është anuluar edhe vitin e kaluar e mos ka ndodhë edhe këtë vit e po mbetem pa projekt.

Drejtori Genc Ademaj- ne e kemi nisur procedurën mjetet janë në dispozicion, projekti është dëmtuar vitin e kaluar, këtë vit janë dëmtuar disa por edhe për ato e kemi filluar procedurat sepse e kemi një mundësi të Qarkorja e parë buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Andi Xhuraj.

Andi Xhuraj- drejtor të tabela sportive nuk na sqarove se sa tabela sportive kanë me u blerë dhe ku kanë me u vendosur. Ashtu siç e di unë I kemi dy tabela sportive. Edhe një pyetje e kam pse nuk po vazhdohet me implementimin e projektit në Rakosh që quhet parku dhe këndi i lojërave se unë e di që aty keni intervenuar bashkë me KFOR-in për pastrimin e atij terreni por nuk besoj që është ndonjë kosto e madhe me u realizuar ky projekt.

Drejtori Genc Ademaj- të pjesa e tabelave, Andi, në Vrellë ku do të funksionalizohet salla e sportit, realisht mungojnë rekuizitat. Më herët pata një debat me Arianin se Ministria e Kulturës ka të planifikuara 1 milion euro për rekuizita sportive. Këtë çështje e kemi diskutuar edhe me drejtoreshën dhe kemi disa pajisje përcjellëse për palestrën në Istog, të cilat i kemi shqyrtuar bashkë me Farukun. Mungojnë disa pajisje për tabelat që i kemi funksionalizuar para dy vitesh. Nuk jam profesionist, por kjo është çfarë më është thënë. Sa i përket Rakoshit, projekti ka qenë i planifikuar, por oferta ka ardhur më e lartë se tenderi. Megjithatë, ai projekt do të fillojë këtë vit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- desha të flas për bartjen e mjeteve për dy çështje. E para ka të bëjë me rrugët në Mojtir, veçanërisht një rrugë drejt varrezave që shpesh ka qenë në projekt, por nuk është realizuar kurrë asfaltimi i saj. Do të doja të di statusin e saj. Çështja tjetër është funksionalizimi i Stacionit të Autobusëve. Është e vërtetë që nuk ka pasur përparim dhe kjo është përmendur edhe nga kolegët. Shpresojmë që bordi i ri që do të zgjidhet së shpejti, bashkë me inspektorin që kemi pritur gjatë të bashkëpunojë me policinë dhe të sjellë ndryshim. Prapë po e them që shpresoj se do të bëhet diçka në këtë drejtim.

Drejtori Genc Ademaj- sa i përket rrugës në Mojstir, të gjitha projektet për rrugë janë pezulluar sepse fshati nuk e ka pasur të ndërtuar kanalizimin e ujërave të zeza. Këtë vit planifikohet faza e tretë e kanalizimit, dhe më pas do të fillojmë me asfaltimin e të gjitha rrugëve në Mojstir. Për Stacionin e Autobusëve, mendoj se do të funksionalizohet. Nëse dështon edhe këtë herë, atëherë do të mbyllet përfundimisht.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdije Bujupaj pashë që në projekt nuk ishte përfshirë rruga “Liridona” në fshatin Dubravë, e cila ende nuk është asfaltuar. Sa janë gjasat që të realizohet asfaltimi i saj?

Drejtori Genc Ademaj- dje isha te rruga në fshatin Dubravë. E kemi matur – është 1340 metra e gjatë dhe ka nevojë për ndërtimin e një ure për shkak të vërshimeve, sipas kërkesës së banorëve. Ka pasur një pengesë pronësore, por tani është zgjidhur. Projekti është buxhetuar vitin e kaluar dhe punimet pritet të nisnin brenda dy muajve.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi nuk ka diskutime të tjera, kalojmë në votim.

Konstatohet që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit kjo Rregullore është sjellë nga ministria dhe duhet ta miratohet siç është. Rregullorja e mëparshme është shfuqizuar. Hapet debati.

Ajshe Metaj -një Rregullore nuk mund të shfuqizohet pa një të re. A e dimë arsyen e shfuqizimit dhe çfarë përmban e reja?

Kryesuesi i Kuvendit- ligjet ndryshojnë dhe rregulloret plotësohen dhe ndryshohen në përputhje. Po votojm. pra, kush është të miratohet kjo Rregullore?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi i Kuvendit-Rregullorja për Subvencione ka ndryshuar për shkak të ndryshimeve ligjore dhe duhet të kalojë në diskutim publik.

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- te kjo Rregullore për tregun ditor jemi ndër të parët në Kosovë që e shqyrtojmë. I uroj punë të mbarë komisionit që e ka hartuar, që të mos kemi probleme në funksionim.

Liridona Lajçi Avdijaj- dua të ndërlidhem me një pikë të Rregullores – në rast se një tregtar përdor dhunë verbale apo fizike ndaj drejtorit të tregut, ti ndalohet përkohësisht apo krejtësisht shitja. Propozoj që ndalimi të jetë i përhershëm, sepse masa e përkohshme nuk mjafton për të parandaluar incidente.

Drejtori Genc Ademaj- kjo është Rregullorja e parë e këtij lloji, prandaj nuk ka ende një bazë të qartë funksionale. Ftoj qytetarët me përvojë në tregje të marrin pjesë në diskutimin publik. Edhe propozimi i Liridonës për ndëshkim më të ashpër ndaj sjelljeve jo etike është i qëlluar. Rregullorja mund të ndryshohet e plotësohet më vonë sipas nevojës.

Andi Xhuraj -sa i përket asaj që u diskutua, te Rregullorja është mirë e shkruar dhe përmban dënime të qarta, nuk ka nevojë për ndryshime.

Agron Gashi -ka shumë paqartësi – nuk dihet çfarë produktesh lejohen, kush e menaxhon tregun, si vendosen çmimet, kush siguron pastërtinë. Kam rreth 70 pika që duhen shtuar.

Ajshe Metaj -Rregullorja është pozitive, në Prishtinë funksionon tregu për çdo ditë. Por shqetësimi është kontrolli sanitar – si do të sigurohet një inspektor sanitar për të garantuar sigurinë ushqimore?

Drejtori Genc Ademaj- tregu që ka me u funksionalizuar, për ju është e panjohur se çfarë do të shitet aty, në Rregullore do të përfshihet, është treg i produkteve të gjelbërta i bylmetit, ndërsa pjesa tjetër e tregut të plaçkave, ne jemi të interesuar të funksionalizojmë ish tregun e kafshëve. Fatmirësisht e kemi inspektorin e tregut, është z. Hysen Mehmetaj dhe është personi përgjegjës dhe kompetent për menaxhimin e tregut, ndërsa sa i përket pjesës sanitare është rajonale, por sa i përket produkteve që shiten është përgjegjës inspektori komunal e atë e kemi.

Andi Xhuraj -Rregullorja do të kthehet për miratim pas diskutimit publik, kështu që mund të shtojmë propozime më vonë. Të kalojmë në votim.

Kryesuesi i Kuvendit -Kush është për kalimin e Rregullores në diskutim publik?

Konstatohet që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- hapet debati. Pasi Rregullorja do të shkojë në diskutim publik, kalojmë në votim.

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Drejtori Genc Ademaj- prezanton pikën e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin, pasi nuk ka diskutime e hedh në votim kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- nei eksploruam këto pika pa hyrë në rend dite kur u propozuan të hynë, kështu që vetëm po i votojmë? Kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 2 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro, 1 kundër dhe 2 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 12.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 13.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin rreth kësaj pike? Nuk ka diskutime e hedh në votim?

Konstatojmë që nga 20 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 2 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 14.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është te shfuqizohet kjo Rregullore?

Konstatojmë që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim shfuqizohet Rregullorja per Kategorizimin e Klubeve Sportive.

Shqyrtimi i pikës 15.

Kryesuesi i Kuvendit- Duhet të informoj se vitin e kaluar sindikata ka kërkuar një informacion në lidhje me shujtat për zyrtarët publikë. Kërkesa është dërguar te kryetari, dhe ekzekutivi ka rënë dakord me çmimin prej 3.50 euro për shujta. Tani hapim debatin, dhe fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe atëherë kur janë ndarë shujtat për punëtorët e komunës dhe stafin civil kam qenë për atë për shkak se e kanë një orar të gjatë të punës. Mirëpo e kam edhe një pyetje tjetër këtu, ne disa obligime në shkollë po i realizojmë përmes kontratës kolektive, komuna ka thënë gjithmonë që nuk ka pasur obligime ndaj këtyre gjërave, unë jam për atë që komuna si komunë edhe pse nuk është ndjerë fajtores se nuk ka pasur obligim se është dëmtuar, por desha të them që nuk po flas për shujta por për disa shpenzime të udhëtimit dhe për disa gjëra të tjera a mundet me marrë obligim komuna siç merr vendime, me ja u paguar shujtat bile neve se paku udhëtimin, se te ne nuk po merren parasysh, njësoj po trajtohet si ai që e ka shtepinë në derë të shkollës si ai që udhëton me kilometra. Është e padrejtë, desha ta di kontekstin edhe pse pak a shumë e di përgjigjen desha një ri konfirmim.

Drejtori Genc Ademaj- E ligjshme nuk është. Kuvendi mund të marrë një vendim, por ligjshmëria do të konfirmohet nga MAPL-ja. Çështja e shujtave mund të procesohen për punëtorët teknikë dhe administrativë të komunës. Në arsim, kjo nuk është e mundur. Shujtat janë për punë, jo për shërbime që krijohen për të shkuar në punë.

Andi Xhuraj- Ne mbështesim këtë propozim dhe jemi të gatshëm të përkrahim edhe rritje në të ardhmen.

Haki Podrimaj- Mbështes marrëveshjen me sindikatën dhe propozoj që në të ardhmen të përfshihen edhe sektori i arsimit dhe shëndetësisë.

Lavdiye Bujupaj - e përkrahu ndarjen e shujtave, por theksoj që për shkak të inflacionit, shumat prej 3.50 euro është e pamjaftueshme dhe kërkoj rritje të saj.

Agron Gashi - Mbështes këtë vendim dhe propozim.

Drejtori Genc Ademaj - a bën një propozim kryesues? Po me vjen mirë për vullnetin politik që e ka Kuvendi i Komunës, ne e kemi bërë një analizë edhe me vullnetin e kryetarit por edhe të juajin po e shoh, kërkesa e sindikatës ka qenë 3.50 euro, po tentojmë me i siguruar mjetet për 4.50 euro e që shumat totale është 570.654 euro për të gjithë punëtorët e administratës nëse ju jeni për. D.m.th kjo është maksimumi pa tatime përcjellëse. Nëse ne e marrim këtë vendim e po dakordohem që pjesa e Kuvendit me e përkrah me shumën 4.50 euro atëherë konfirmimi i ligjshmërisë na vjen neve pozitiv, atëherë unë në mbledhjen tjetër e marrë përsiper me e hedh në votim ndryshimin e kategorisë që mos me pas keq klasifikim nga ana e përmblyesve, dakordohem që cilat projekte ose te cilat kategori ekonomike bashkërisht i prekim dhe i transferojmë në kategorinë paga dhe mëditje që me ligj është e përkaktuar lëvizja, pastaj ajo shkon te ministria e Financave, bazuar në vendimin e Kuvendit, ministria e gëzon të drejtën shtesë a na aprovon arsyetimin çfarë e kemi, kjo është procedura që mos me na u hakmarrë në performancën, sepse pastaj duke tentuar të bëjmë mirë mundemi me e humb grantin e performancës për shkak të keq klasifikimit. Duhet ta kemi parasysh që ky akt nuk duhet të shkojë në asnjë mënyrë përmes gjykatës ose me shkuar përmes procedurës përmbartimore. Kështu që unë kryesues kërkoj, te pjesa e vendimit të Kuvendit, para hartimit të vendimit të Kuvendit sindikata me e lëshuar një njoftim që akti i Kuvendit mos të përcillet te organet e tjera përpos organit të Kuvendit dhe të ministrisë së Financave. Mendoj që është fer mos me na dëmtuar pastaj me procedura tjera sepse nuk e besoj që një shërbyes civil e ka vullnetin me i marrë 2.000-3.000 euro e me ja humb komunës 1.000.000 euro. Ne duam të tentojmë në formën ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtor dhe ju anëtarë të Kuvendit, prej pervoje herën e kaluar, është metoda edhe prej komunave tjera që e kanë aplikuar jo vetëm te shujtat, por edhe te këto të arsimit me kontratë kolektive. Me marrëveshje gjyqësore që mos me u fut në obligime me përmblyes. Sindikata duhet me e marrë këtë zotim, që këtë vit nuk ka shanca se janë edhe ato të arsimit, kështu që këto me i lënë për vitin e ardhshëm. Unë drejtor propozoj kështu.

Drejtori Genc Ademaj- po e lëmë të përgjithshme, brenda mundësive buxhetore që komuna e Istogut i gëzon për vitet fiskale në vijim.

Kryesuesi i Kuvendit- Ministria e Financave e kthen përmes MAPL-së. Nuk e kthen negativ, por e kthen sa të holla i ke për subvencionim siç e ka kthyer herën e kaluar.

Drejtori Genc Ademaj- një informacion që me erdh, ligji e parasheh që përfaqësuesi i sindikatës dhe komuna me të dakorduar për procedurat e realizimit, d.m.th kjo qenka e mirë, që pjesë e vendimit me qenë edhe neni i ndërmjetësimit mes sindikatës dhe komunës që mos me na prodhuar pastaj obligime tjera financiare jashtë vullnetit që e ka Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtor mua më duhet të drejtohem para Kuvendi se duhet të votohet me çmim.

Drejtori Genc Ademaj- unë jam për çmimin 4.50 (katër euro e pesëdhjetë cent) pra për 130.000 euro më shumë se sa ka qenë kërkesa e sindikatës me 3.50 (tri euro e pesëdhjetë cent) dhe besoj që nuk është ndonjë dëm i madh për komunën. Dhe është një pagesë me e arsyeshme për punëtorët.

Kryesuesi i Kuvendit- unë të falenderoj në emër të të gjithë punëtorëve të komunës, të zjarrëfiksëve, shtëpisë së Kulturës.

Drejtori Genc Ademaj- kryesues ata le të falenderojnë kryetarin.

Kryesuesi i Kuvendit- po e falenderojmë kryetarin për bashkëpunimin që e ka pasur me sindikatën e këtu po të falenderoj ty për këtë një euro. Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- desha të jap një propozim mos po e ndihmon procesin, që pjesa e pagesës mund të ndahet me këste. Në shume komuna tjera parashihet që të jetë. Nëse kemi një pjesë të mjeteve në fund të vitit, me të dhënë ato, vitin tjetër pjesën tjetër d.m.th mos ta mbyllim me njëherë.

Kryesuesi i Kuvendit- ashtu e kuptova edhe drejtorin kur të ka mjete me të dhënë. Na duhet me e bërë me specifikim.

Drejtori Genc Ademaj- një sqarim, realisht me ligjin e ri të pagave, nëse e dini kur e kemi bërë planifikimin e buxhetit, edhe anëtarët e Kuvendit janë pjesë e listës së rregullt të pagave ju takon ajo shtesë. Për një vit ju takon. Nëse ata i marrin 3.000 euro juve ju takojnë 1.000 euro.

Kryesuesi i Kuvendit- ju lutem vëmendje, se duhet me e specifikuar votimin se për çfarë po votojmë. Propozohet, që shujta të jetë 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe pagesa të bëhet me marrëveshje ndërmjet zyrtarit ligjor të sindikatës dhe përfaqësuesit të komunës kryetarit. Pagesa të jetë me negociim.

Drejtori Genc Ademaj- une mendoj që titulli i vendimit të jetë, ndarja e shumës buxhetore prej 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) për të gjithë punëtorët e administratës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- e pata kërkesën me ja bërë kryetarit të sindikatës që në të njejtën mënyrë edhe neve pagesën, ne nuk po kërkojmë 4.50 euro po mjafton 3.50 euro.

Drejtori Genc Ademaj- a ka mundësi ne me përfunduar kontratën kolektive.

Kryesuesi i Kuvendit- po votojme pra. Sindikata është pajtuar me 3.50 euro, (tri euro e pesëdhjetë cent) për këtë po e falenderojmë kryetarin që është 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe po votojmë me 4.50 euro (katër euro e pesëdhjetë cent) dhe me modalitetet që do ti bëjnë zyrtarët ligjore të të dy palëve. Kush është për?

Konstatojmë që nga 18 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i pikës 16.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- është kërkuar që rruga “Shaban Hajzeraj” të rregullohet për vite, vetëm dua të di nëse është në procedurë. Po ashtu, kam një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë për ambulancën në Uçë – çka po ndodhë me të? A do të funksionalizohet apo ka ndonjë plan tjetër? Gjithashtu, banorët kërkojnë një teknik medicinal, dhe kam propozuar që një teknik e licencuar, bashkëshortja ime, mund të shërbejë pa pagesë dy herë në javë. Për kryetarin, kisha një vërejtje për mos praninë e tij në disa aktivitete për dëshmorët, por nuk është këtu, kështu që mund ta diskutojmë një ditë tjetër.

Drejtori Genc Ademaj- për rrugën “Shaban Hajzeraj”, këtë vit është ndarë buxheti dhe do të realizohet. Për ambulancën, kemi diskutuar me kryetarin dhe do të dërgojmë një teknik medicinal për shërbime bazike, dhe ajo do të funksionalizohet brenda dy muajve. Sa i përket mos-pranisë së kryetarit, është e vërtetë që ai nuk ka marrë ftesa për disa aktivitete, që janë organizuar ad-hoc për dëshmorët, dhe nuk është informuar për to. Kjo është e pandershme, pasi mund të bëjmë një agjendë të përbashkët për ditën e dëshmorëve. Kemi një memorial për dëshmorët ku janë investuar mbi 1 milion euro, dhe ky është vendi më dinjitoz për t'i nderuar. Organizimet ad-hoc kanë krijuar ndasi, dhe është e papranueshme të bëhen pa njoftuar kryetarin, duke tentuar të krijohet ndarje politike, veçanërisht tani në vit zgjedhor.

Negjdet Ramaj- në lidhje me përvjetorin e Dëshmorëve të Vrellës, është e vërtetë se ka pasur organizim publik ku ka pas fjalë rasti edhe kryetari i komunës së Istogut, së bashku me z. Xhavit Jashari. Megjithatë unë edhe për ngjarjet e tjera, si ato në bjeshkët e Uçës, e ftoj kryetarin dhe kryetari nuk merr pjesë, edhe pse është ftuar personalisht. Ish-kryetari Rugova, përkundrazi, ka marrë pjesë në këto përvjetore sa herë është ftuar.

Drejtori Genc Ademaj- nuk mundem të flas deri në këtë nivel në emër të kryetarit por prej bisedave që i kemi pasur po ta them me përgjegjësi që ka vullnet më shumë se gjithësecili këtu me marrë pjesë. Vazhdon sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- Pata me e marrë një Informacion nga ekzekutivi deri me 28 prill 2025 ka qenë afati i fundit për aplikim për të përfituar nga nisma Wi-Fi për Ballkanin Perëndimor e cila ofronte hotspote Wi-Fi falas deri në 500 komuna në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Pikat e Wi-Fi-se do të instalohen në hapësirat publike si sheshe, parqe, biblioteka, muze dhe shkolla. Desha ta di a keni aplikuar në këtë nismë?

Drejtori Genc Ademaj- jemi komuna e parë që kemi aplikuar në vitin e parë kur është hapur thirrja publike, fatmirësisht ka qenë aty edhe një familjar i Liridonës që na ka asistuar në aplikim. Ne si komunë e kemi parë të arsyeshme pjesën e parkut, kanë me u vendosur 6 hotspote, pjesa e komunës dhe e parkut kanë me përfituar prej atij furnizimi, është një projekt i mirë deri tani nëse nuk gaboje vetëm 7 komuna kane aplikuar, e ne jemi e para në ditën e parë që kemi aplikuar. Uroj të jemi fitues.

Kryesuesi i Kuvendit- Andi Xhuraj e ka fjalën.

Andi Xhuraj- mendova se po zgjatet shumë ajo tema të respektimi të familjarëve të dëshmorëve e këto. Negjdeti e tha shume mirë. E të pjesa a ka qenë kryeministri i pari, e kush po vjen më shumë e kush më pak nuk po e shoh të arsyeshme në atë temë të ndjeshme me u përdor ky lloj komunikimi.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- edhe unë nuk desha me i debatuar vizitat të përmendoret, është një ditë e dëshmorëve, por familjarët kërkojnë me e pasur një organizim të veçantë. E kisha pasur dëshirë të them që ata që janë martir e dëshmorë nuk kanë rënë për të pasur grupacione politike faktikisht kisha dashur që të gjithë të trajtohen njësoj. Rastësisht në Kamenicë të familja Lipaj pashë një organizim shumë të mirë. Nuk është pak me pas një vizitë se edhe ata kanë rënë që ne të jemi të lirë. E nuk duhet me e kursyer as kohën as asgjë. Pajtohem plotësisht me Andin në atë

se çfarë e tha. Nuk ka me fituar poena politik mbi diçka që nuk duhet me qenë. Prandaj sugjeroj ose të bëhet një ditë për të gjithë ose të shkohet në të gjitha vendet ku organizohen këto e mos të bëhet padrejtësi.

Kryesuesi i Kuvendit- faleminderit Ajshe. A ka edhe dikush pyetje. Jo atëherë,

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,

E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.

Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:10

Procesmbajtëse,
Flora Bujupaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

